

## NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore në Prizren – Departamenti për Krime të Rënda, në trupin gjykues të përbërë prej gjyqtarës Raima Elezi, si kryetare dhe gjyqtarëve Vjollca Buzhala dhe Alia Fazljiji, si anëtarë, me sekretaren juridike Valdete Zurnaxhiu, në lëndën penale kundër të akuzuarit B. V. nga Shkodra, Republika e Shqipërisë, për shkak të veprës penale të grabitjes nga neni 255 par. 3 e lidhur me par. 1 lidhur me nenin 23 të KPK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren, Departamenti për Krime të Rënda PP.nr.152/2011 të datës 30.11.2011, pas mbajtjes së seancës kryesore publike në praninë e Prokurorit të Shtetit në Prizren Mehdi Sefa, të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij av. B. N. nga Prizreni, me datë 04.05. 2016, publikisht morri dhe shpalli këtë

## A K T G J Y K I M

**I akuzuari B. V.**, nga i ati M. dhe e ëma S. e lindur Z., data e lindjes ... në Shkodër Republika e Shqipërisë, shqiptar Republikës së Shqipërisë, gjendet në paraburgim.

## ËSHTË FAJTOR

Sepse me datë 09.12.2010 rreth orës 16:50 minuta në Prizren, në lagjen Bazhdarana, i akuzuari B. V. së bashku me shokun e tij R. K. përvetësojnë pasurinë e luajtshme të ndërmarrjes shërbyese “N.” e cila kryen edhe shërbimet e agjencisë për transferim e parave “V. U.”, me qëllim që vetes të sjellë pasuri të kundërligjshëm duke përdorur dhunën dhe armën kundër të dëmtuarës D. P. që do të sulmojnë atë qasshëm jetën apo trupin e saj, në atë mënyrë që vendosin maska në kokë, armatosen dhe në mënyrë të dhunshme i akuzuari R. K. e hapë derën me forcë ashtu që dera thuhet dhe bien mbi të dëmtuarën D., afrohet me brutalitet te sirtari tavolinës ku gjenden paratë, ndërsa i akuzuari B. V. qëndronte tek dera duke drejtuar armën- pistoletën në drejtim të personave që ishin tek kafeteria “K.” duke i udhëzuar ata që të mos afrohen brenda, kështu që mundëson R. K. të grabit parat në vlerë prej 2.480 € dhe pasi marrin këto para bashkërisht largohen nga vendi i ngjarjes duke dal prapa objektit me vrap në drejtim të lagjes Kurrilla,

- me këtë ka kryer veprën penale të grabitjes nga neni 255 par. 3 lidhur me par. 1 lidhur me nenin 23 të KPK.

Gjykata në bazë të nenit 7, 8, 9, 10, 21, 41, 42, 43, 44, 45, 73, 74, 76, 82 dhe neneve të përmendura më lartë të KP, e

## G J Y K O N

me dënim me burg në kohë zgjatje prej 3 (tre) vite, në të cilën dënim i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim datës 21.11.2014.

E dëmtuara D. P. për realizimin e kërkesës pronësoro juridike, udhëzohet në kontest të rregullt civil.

Obligohet i akuzuari të paguajë të gjitha shpenzimet e procedurës penale sipas llogaris së gjykatës ndera në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumë prej 150 €, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria e Qarkut në Prizren ka ngritur aktakuzën PP.nr. 152/11 të datës 30.11.2011, kundër të akuzuarve R. K., nga Prizreni dhe B. V. nga Shkodra Republika e Shqipërisë, për shkak të veprës penale të grabitjes nga neni 255 par. 3 lidhur me par. 1 lidhur me neni 23 të KPK.

Prokurori i shtetit në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë aktakuzës PP.nr.152/12 të datës 30.11.2011, me disa precizime në dispozitivin e aktakuzës sa i përket gjendjes faktike pasi që në bazë të provave të administruara është vërtetuar se në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale për të cilën akuzohet. Në bazë të provave edhe atë dëgjimit të ekspertit R. Z. i Drejtorisë së Forenzikës, nga sektori i imazhit digjital të qartësuar nga video incizimi dhe duke bërë krahasimin e këtyre imazheve në kazonin “L. V.” në Prizren si dhe në ndërmarrjen “V. U.”, në lagjen Bazhdarana është marrë konkluzioni përmes krahasimit të veshjeve të tyre, mënyrës së kryerjes së veprës penale, konstruksionit trupor, agresivitetit të shprehur gjatë kryerjes së veprës penale, të maskuar në regjionin e njëjtë të operimit, është ardhur në përfundim se të akuzuarit B. V. dhe R. K. janë kryesisht të veprës penale të grabitjes që ka ndodhur ditën kritike në lagjen Bazhdarana, në ndërmarrjen shërbyese “V. U.

Gjendja faktike e përshkruar si në diapozitiv të akuzës është mbështetur edhe në deklaratën e të dëmtuarës në cilësinë e dëshmitares, D. P. si dhe dëshmitarëve A. K, E. K. dhe Xh. V., po ashtu edhe nga të dhënat e hartografisë të nxjerra nga PTK për numrin e telefonit 045-4... që i përket të akuzuarit B. V. dhe pas dëgjimit të ekspertit të PTK-së është vërtetuar prezenca e të akuzuarit B. V. me datën 09.dhetor 2010 në ora 16:44 minuta, 6 minuta para grabitjes, numri në fjalë që i përket B. është regjistruar në perimetrin e antenës Prizren – Shtëpia e Bardh e cila antenë i përket operatorit “Vala 900” dhe është montuar jo shumë larg nga ndërmarrja shoqërore “N.” gjegjësisht “V. U.” ku edhe ka ndodhur grabitja.

Andaj duke marrë për bazë gjendjen e provave të cilët janë administruar nga ana e trupit gjykues Prokurori i shtetit konsideron se në veprimet e të akuzuarit B. V. formohen të gjitha elementet e veprës penale për të cilën është akuzuar, me propozim që trupi gjykues të njëjtin të shpallë fajtor dhe të dënojë sipas ligjit. Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin gjykata duhet të ketë parasysh të gjitha rrethanat konformë dispozitës së nenit 73 të KP, edhe atë shkallën e përgjegjësisë penale të tij, intensitetin e rrezikut apo vlerës së mbrojtur, karakteristikat e tij personale si recidivist në kryerjen e veprave penale të natyrës së njëjtë.

Mbrojtësi i të akuzuarit, av. B. N. në fjalën përfundimtare ka deklaruar se në rastin konkret i akuzuari B. V. ka refuzuar të japë mbrojtjen e ky fakt assesi nuk mund të mirët si mbrojtje në heshtje. Në rrethana normale pas një veprimi të këtillë të të akuzuarit

mbrojtësi duke ndjekur të akuzuarin është dashur të refuzojë dhënien e fjalës përfundimtare përkatësisht argumentet e mbrojtjes. Duke patur parasysh të gjitha rrethanat të kësaj procedure dhe mundësit e keqinterpretimit të refuzimit të dhënies së argumenteve përmbledhëse nga ana e mbrojtësit, si mbrojtësi i tij përmbledhë disa fakte dhe argumente të cilat i konsideron të favorshme për të mbrojturin e tij. Së pari ndarja e procedurës në veprën penale në bashkëkryerje nuk lejohet. Pretendimet e akuzës që në rastin konkret kemi të bëjmë me vërtetimin e gjendjes faktike, me krahasimin e provave për një vepër tjetër penale edhe atë me supozim të krahasimit të një fotografisë në të cilën shihen dy vija në një veshje, me gjasa sportive si dhe supozimet të fizionomisë të kryesve, është jo vetëm e palejuar por në kundërshtim me dispozitat ekzistuese si materiale ashtu edhe procedurale. Pretendimet se në rastin konkret me dëgjimin e ekspertëve, të cilit në fakt janë deklaruar se janë vetëm dëshmitarë, pretendohet se është vërtetuar se i mbrojturi i tij është një prej kryesve të veprës penale. Pastaj sipas aktakuzës hartografia, e cila në një mënyrë është administruar si provë por jo ashtu si duhet dhe sa duhet, ka vërtetuar se i akuzuari B. paska qenë në afërsi të vendit ku është kryer vepra penale duke mënjanuar faktin se eksperti në asnjë mënyrë nuk ka mund të deklarohej lidhur me vendin eventual ku ka mund të gjendej numri për të cilën pretendohet. Ka shtuar se në rastin konkret pretendimi i recidivitetit është një pretendim jo i saktë për arsye se nëse krahasohet data e veprës për të cilën është dënuar i mbrojturi i tij, e që paraqet bazë për vërtetimin e kësaj vepre, e natyrisht se kjo absolutisht nuk lejohet sepse shihet qartë se ajo vepër ka qenë e kryer me një datë të mëvonshme nga vepra e cila është objekt i kësaj procedure. Konsideron se çdo krahasim i pretenduar me një vepër tjetër penale paraqet jo vetëm shkelje por edhe një ndërlikim dhe cila vë në dyshim mundësinë e ekzistimit të një veprimit të kundërligjshëm e që në fakt paraqet shkeljen e dispozitave të nenit 3 të KPP. Duke patur parasysh të gjitha këto rrethana konsideron se në rastin konkret me asnjë provë nuk është vërtetuar se i mbrojturi i tij në çfarëdo mënyrë të ketë qenë implikuar në kryerjen e veprës penale për të cilën akuzohet me këtë aktakuzë, prandaj propozon që i njëjti të lirohet nga akuzat.

I akuzuari B. V. në fjalë përfundimtare ka theksuar se nuk do të japë fjalën përfundimtare por shënim për procesverbal. Si gjithëherë gjatë 49 muajve të procedurës sipas mendimit të tij kjo procedurë nuk është ligjore, meqenëse është i burgosur dhe i sjellë dhunshëm, është i detyruar me dhënë shënime. Aktakuza PP.nr. 152/11 me datën 30.11.2011 është e paligjshme, mendon se edhe procedura është e paligjshme për procedurën e tij e kjo vërtetohet me shkresat e lëndës e jo që ai duhet me thënë, aktakuza thirret në një aktgjykim që është marrë në vitin 2013 për rastin tjetër P.nr. 208/13 me datën 11.09.2013, i cili aktgjykim është i plotfuqishëm, do të thotë me këtë aktakuzë është shpallë fajtor për veprën penale të grabitjes në kazinonë “L. V.” në Prizren, ky aktgjykim është i falsifikuar për të mbrojtur një aktgjykim i cili është marrë më përpara për të njëjtin rast në “L. V.”, P.nr. 136/11 me datën 23.12.2011. Andej nuk e kam të qartë ku bazohet aktakuza kur bazohet në një aktgjykim tjetër për “L. V.”, me datën 17.08.2015 për herën e parë ka dëshmuar eksperti i hartografisë dhe atë është vërtetuar se unë natën kritike në kazinonë “L. V.” nuk jam, siç më kanë shpallë fajtor me dy aktgjykimet e falsifikuar të rastit “L. V.” e në të cilat bazohet kjo aktakuzë. Prezantoj edhe hartën e hartografisë ku shihet se ku kam banuar unë e ku gjendet kazinoja “L. V.” në të vërtet, ndërsa në shkresat e lëndës përmendet se kjo kazino gjendjen në qendër të qytetit . Nuk e di pse është vepruar kështu por kjo është e qëllimshme. Edhe me datën 05.04.2015 pas deklarimit të hetuesit F. Th. i cili ka dhënë deklaratë për herë të parë dhe të vetme për dy raste, sikur të ishin dy raste duke u gjykuar bashkë, e të vërtetohet qëllimi i keq i të dy akuzave që të më dëmtojnë sa më shumë me burg , dhe në asnjë shkresë nuk

shkruhet zona e banimit tim në të dy raste qëllimisht më vonë merret veshë në bazë të shkresave kur edhe del qëllimi i keq. Me datën 03.04.2015 hetuesi e pranon se rruga për me shku në Bajër ku unë kam banuar, kalon aty, përkatësisht fjala është për “L. V.” edhe “V. U.”, fshehja e këtij fakti prej fillimit dhe qëllimisht është bërë për me manipuluar rastin. Me datën 03.04.2015 për herë të parë doli në shesh fakti elementar që ka të bëjë me vendbanimin tim dhe që ka të bëjë me manipulimin e tërësishëm për të marr një aktgjykim të paligjshëm dhe të falsifikuar siç është marr herën e parë me 23. dhjetor 2011. Me hartografi vërtetohet se unë nuk kam qenë në qendër të Prizrenit, nuk kam qenë në “L. V.” edhe aktakuza që thirret në këtë rrethanë përkatësisht aktakuza për “N. – V. U.” që thirret në rastin “L. V.” gabon rëndë. E kjo akuzë më shpall fajtor para se gjykata të merr vendimin lidhur me rastin e “L. V.”, parashtrahet pyetje se ku prokurori ka ditur që unë do të shpallej fajtor, që do të thotë se fshehët diç tjetër e diç tjetër, ka dalë në shesh me datën 25.qershor 2015. Ku prokuroria speciale publikoi çështjen e firmës “N.” lidhur me dyshimin për financimin e terrorizmit dhe shpëlarjes e parave për kohën që ka të bëjë me grabitjen e “N.”. Dhe bashkëpunëtorët e kësaj zyre janë drejtorë të Komunës së Prizrenit, është një kushëri i dëshmitarit X. V. është edhe kushëri i prokurorit Sylë Hoxha, kjo akuzë e ka detyruar gjykatën të më shpallë fajtor, përkatësisht është në mundësi që e ka detyruar për të më shpall fajtor për të bluar diç. Aktgjykimi i gjykatës Themelore në Prizren P.nr. 208/13 të datës 11.09.2013 është marr vetëm e vetëm për me mbrojtje aktgjykimin P.nr. 136/11 e datës 23. Dhjetorë 2011, të po të njëjtës gjykatë, sepse ai aktgjykim është korrigjuar, është modifikuar, ka mundësi më 2013 kjo e njëjta vërtetohet nga aktgjykimi P.nr. 208/13, nga se të gjitha rrethanat të cilat kanë qenë të papranueshme dhe të paligjshme me aktgjykimin 208/13 janë përmirësuar, gjyqtari i cili ka gjykuar rastin P.nr. 208/13 njëkohësisht ka qenë gjyqtari paraprak në rastin “N.” dhe ka ditur se nevojitet shpallja edhe vërtetimi i fajësisë në “L. V.”. Me datën 22.03.2016 kryetari i gjykatës ka marr një vendim që ja mundëson palës – mua që të kërkojë të drejtën te organi tjetër, ndërsa kërkesa ime është për rishikim të rastit “L. V.” se për këtë rast kemi vetëm aktgjykim të paligjshëm dhe falsifikim që i bjerë që aktakuza ku po bazohet. Unë po bazohem vetëm në shkresa që më keni dhënë ju dhe asnjëherë nuk ka pas provë. Me datën 25.02.2011 më është caktuar masa e paraburgimit për herë të parë dhe aty gjyqtarja e arsyeton vendimin kallëzimin penal që ka bërë Njësi i hetimit rajonale dhe provat të bashkangjitura, kurse aktakuza 49/11 e vërteton se gjyqtarja që ka marr aktvendimin Hep.nr. 28/11, nuk ka pas asnjë provë për caktimin e paraburgimit për sa i përket veprës penale nga neni 205 par. 3 dhe 1 KP, ky aktvendim për caktimin e paraburgimit është e kundërligjshëm e kjo vërtetohet nga aktakuza ngase nuk ka pas asnjë provë nga se provat e theksuar në këtë aktvendim me datën 25 ku theksohet se gjykatësi posedon provat, prokuroria i ka mbledhë me sajime dhe intriga pas 3 ditëve që do të thotë është me kundërshtimin e gjykatës që ekzistojnë provat. Rrethana e vetme e gjykatës për me më mbajte në arrest është fletë arresti ndërkombëtarë që ka lëshuar R. e Shqipërisë. Edhe me datën 01.03.2011 me aktvendimin Hp.nr. 75/11 u mbrojt si i drejtë dhe i ligjshëm aktvendimi 28/11 të datës 25.02.2011. Me të gjitha këto vërtetohet ortakëria prokurori -gjykatë për krejt që është bërë kundër meje. Janë kënaqur, janë gëzuar dhe kanë përgatitur për fletë arrestin e Shqipërisë, ngase ata të Shqipërisë janë të ligët dhe kriminel, e dini vetë. Edhe kjo arsye për paraburgim të datës 25.02.2011 u trafikua në mënyrë kriminale në Pejë nga se nuk u procedua në gjykatën e Prizrenit ku është marr edhe vendimi për paraburgosje. Me datën 21. Nëntor 2014 më arreston një gjykatë krejt tjetër bazuar në fletë arrestin e Shqipërisë, këtu vërehet qëllimi dhe bindja se çka është “made in Albania” nuk vlen për prokurorin, policinë dhe gjykatën. Po marr një shembull tjetër për “L. V.”, pra Prokurori i Qarkut propozon që të qohen të gjithë akuzuarit në këmbë dhe dëshmitari kthehet nga ata dhe patet a mund të bënë krahasimin të cilit kanë

qenë nga ata dy persona atë natë në lokal, dëshmitari i kthyer kah banka e ekzekutimit ku janë të akuzuari të ngritur në këmbë, me dorë tregon në drejtim të akuzuarit B. V. Pra edhe këtu e di që autorët e grabitjes kanë qenë të maskuar e dëshmitari bëri me gisht sipas kërkesë së prokurorit, kur prej gjyqtares e cila është edhe sot këtu është pyetur “ku po din ti se kush është autori që pamë në video që po drejtohet gisht se ata ishin të maskuar si shihet në video”, dëshmitari u përgjigje gjyqtares “unë nuk e di se kush tek, na kanë mësuar na kanë treguar fotot e të akuzuarve, këta janë ata autorë që ju kanë grabitë”, kjo i bjerë se dëshmitari ka qenë i dresum , mashtrues dhe i detyrum prej prokurorisë dhe policisë. Kur protestova unë gjyqtarja më ka thanë se “ shuj B. rregullohet në fund” dhe në fund doli aktgjykimi i paligjshëm i falsifikuar. Dëshmitari M. M. deklaratën e tij e bëri horë prokurorin se i ka mashtrua i ka rrejte dhe sipas M. M. prokurori nuk ka zënë autorin por ka bërë çka ka dashtë, edhe gjyqtarja ka biseduar diç në gjuhën serbishte me dëshmitarin që unë nuk e kam kuptuar. Kjo për të vërtetuar se çka do të është e Shqipërisë është kriminale. Ndërsa aktgjykimi 136/13 vërtetohet se është bërë ekspertiza e në të vërtetë nuk është bërë asnjëherë ekspertiza për identifikimin e personave. Theksoj se më është mohuar e drejta për të pritur vendimin e gjykatës së Apelit, të gjykatës Kushtetuese lidhur me rigjykimin e rastit “L. V.” dhe të gjykatës Kushtetuese lidhur me kushtetutshmërinë e atyre aktgjykimeve të cilët janë të lidhura me rastin “L. V.”. Konstatoj në fund se aktakuza nuk është vërtetuar me asnjë provë.

Gjatë shqyrtimit kryesor është bërë shikimin në dy Compad Dick, lidhur me rastin 2010-GA-3698 dhe 2010-GA-3923, nga të cilat shihen personat me konstruksion njëri më i shkurt dhe tjetri më i gjatë, sjellja e tyre në lokalet dhe veshja gjatë kryerjes së veprave penale,

Është bërë shikimi në foto dokumentacion nga vendi i ngjarjes gjatë kryerjes së veprave penale – imazhet e qartësuar nga video incizimet e datës 25.05.2011, nga shihet se personat e maskuar me pistoleta në duar si dhe hapësira në të cilën është kryer vepra penale.

Është bërë leximi i informacionit “W. U.” lidhur me tërheqje parash nga i cili vërtetohet se i akuzuari B. V., gjatë vitit 2010 dhe 2011 ka tërhequr 20 (njëzetë) herë para nga disa institucione bankare për mes tjerash edhe në NTSH “N.” me datat 19.02.2011, 09.02.2011, 14.01.2011, 20.10.2010 si dhe i akuzuari R. K. dy herë në NSH “N.” me datat 26.01.2009 dhe 06.10.2010, transaksionet financiare me shërbim të kryer të datës 12.04.2011 dhe tri vërtetime për tërheqjen e të hollave me numrat 7399405 nga i cili vërtetohet se me datën 06.10.2010, bëhet tërheqja e parave nga R. K., në shumën prej 69.89 Euro, nr.7299714 bëhet tërheqja e parave nga i akuzuari B. V. në shumën prej 70.25 Euro.

Është bërë leximi i raportit për hyrje dalje të telefonave të të akuzuarve së bashku me SMS për periudhën kohore prej datës 10.11.2011 deri më datën 08.01.2010, nga i cili vërtetohet se sipas SMS telefonike, me datë 09.12.2010 B. V. nga numri i tel.045-4..., para se të ndodh grabitja ka dërguar një SMS telefonik R. K., në numër telefoni 044-5., në të cilin SMS kishte shënuar një numër telefoni 044-1..., i cili numër sipas SMS i përket një personi me emrin J., pas grabitjes në ora 18:27 minuta, dërgon një SMS R. K., ku i shkruante “jam me dy tezak tu luajt zhol te vendi të presim”. Sipas thirrjeve telefonike me datën 09.12.2010, R. K. përmes numrit të tij të tel.044-5..., para se të ndodh grabitja ka komunikuar me B. V. në numër të telefonit 045-4..., në ora 14:38:59, kurse pas grabitjes kanë komunikuar në mes vete në ora 17:33:01 minuta, nga raporti po ashtu vërtetohet se

numri i telefonit 045-4..., ka thirr numrin 044-5..., 12 (dymbëdhjetë) herë me datën 09.12.2010, prej orës 03:25:54, deri në ora 15:57:33, dy herë në ora 17:40:10 dhe 18:27:48, 7 (shtatë) herë prej orës 20:31:05, deri në 21:08:45, dhe në ora 22:54:42,

Është bërë leximi i hartografisë me datën 09.12.2010, në të cilin raport nuk janë regjistruar të dhënat me lokacionin e numrit të telefonit 044-5..., e i cili numër i përket R. K. I akuzuari B. V. sipas hartografisë se numrit të tij të telefonit 045-4... me datën 09.12.2010, në ora 16:44 (rreth 6 minuta) para grabitjes është regjistruar në perimetrin e antenës PZSH Bardh-1, e cila antenë i përket Valës 900 dhe e cila antenë është e montuar jo shumë larg në N.Sh “N.”, ku ka ndodhur edhe grabitja.

Në bazë të provave të administruara gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

I akuzuari B. V. është shtetas i Republikës së Shqipërisë i cili pa ndonjë arsye të caktuar ka ardhur në Prizren, rastësisht ka shkuar në teqenë e Sh. Xh., ku është njoftuar me të akuzuarin R. K. me të cilin ka filluar të shoqërohet. Për disa kohë ka qëndruar në teqe e më vonë është vendoset në një shtëpi të braktisur jashtë qytetit në kushte jashtëzakonisht të vështira. Të akuzuarit B. dhe R. kanë vazhduar të shoqërohen dhe në mes vete janë vizituar, madje ka ndodhur që ndonjëherë të qëndrojnë si mysafir edhe për disa ditë. Ditën kritike rreth ora 16, 44 të dy kanë shkuar në “W. U.” në lagjen Bazhdaranë, paraprakisht të maskuar me maska të zeza, i akuzuari R. me revole në dorë ka hyrë i pari në lokal nga dera anësore, brenda ka qenë e dëmtuara D. P., punëtorja e cila punonte në sportel, është afruar te sirtari i tavolinës ku ka punuar e dëmtuara dhe kanë qenë arrkat me para, nga të cilat ka marrë shumën e gjetur të parave. Gjatë kësaj kohe i akuzuari B. ishte brenda në lokal me pistoletë në dorë të drejtuar kah personat të cilët kanë qenë përball në kafeteri “C.”, pastaj janë larguar nga vendi i ngjarjes.

Këtë gjendje faktike gjykata ka vërtetuar në bazë të deklaratës së të dëmtuarës D. P., deklaratave të dëshmitarëve A. K., Xh. V., E. K., B. D. dhe F. Th., deklaratës së ekspertit R. Z., si dhe nga provat materiale - raporti i hyrjes dhe daljes dhe SMS, raporti informues nga W. U., shikimi në Compad Disc dhe foto dokumentacioni nga vendi i ngjarjes.

Në mbrojtjen e vet në shqyrtimin kryesor i akuzuari B. V. duke mohuar kryerjen e veprës penale ka deklaruar se mbetet pranë deklaratës së dhënë më dt.15.07.2011, pranë policisë, duke theksuar se i duket se ka shkuar në NSH “N.” në lagjen Bazhdarana në Prizren ku kryhen shërbimet e Agjencisë “V. U.”, ku ka nxjerrë paratë që i kanë dërguar familja. Gjatë qëndrimit në Prizren ka pasur një pistoletë të cilën e ka mbajtur në çantën e punës, pistoletë ka qenë e tipit “Zastava”, ngjyrë e zezë por nuk i kujtohen sa plumba kishte sepse atë ditë kur ka ardhur policia dhe e kanë arrestuar pistoletën e ka lënë nën kauç. R. K. nuk ka mbajtur ndonjë armë sa e di. Është e vërtet që me datën 09.12.2010 ka shkruar një mesazh dhe ka dërguar R. para orës 04:00, në mëngjes me të cilën ka dashur ta përkujtonte që mos të harronte në mëngjes të kryej shërbimin lutjen “ishrah”. Nuk e mban mend ku ka qenë ditën kritike në ora 16:44 minuta. Nuk ka dëgjuar për grabitjen e ndodhur në lokalin “V. U.” ku i ka nxjerrë paratë dhe nuk e mban në mend se a ka shkuar R. K. të nxjerrë paratë për të në atë lokal. Në shqyrtimin kryesor ka shtuar se 13.01.2010 ka ardhur në Kosovë nga Turqia, ka udhëtuar me aeroplan dhe në Kosovë ka hyrë përmes vijës kufitare të aeroportit në Prishtinë me pasaportën e Republikës së Shqipërisë dhe ka qëndruar në Prizren. Ka punuar si punëtor krahu në ndërtimtari me mëditje gjatë tërë

kohës ose gjatë tërë vitit. Ka qenë i ftuar mysafirë tek R. K. dhe janë bërë shokë të pandarë. Dinë ku gjendet lokali V. U. “N.”.

E dëmtuara D. P. ka deklaruar se është punëtore e ndërmarrjes shoqërore “V. U.” “N.”, në Lagjen Bazhdarana në Prizren, veprimtaria e kësaj firme është transferimi i parave dhe shërbimi i klientëve të cilëve u dedikohen para nga jashtë. Ditën kritike rreth orës 16:50 minuta ka qenë në ndërrimin e punës, i kujtohet se një myshteri që e kanë afër ka kërkuar disa para të imta dhe pasi ka dalë jashtë, brenda ka mbetur vetëm kur papritmas dy persona të maskuar me pistoleta në duar kanë hyrë brenda, njeri ka qenë i gjatë për afërsisht me trup 1.85cm ai është drejtuar kah banaku ku ajo ka punuar, ka qenë i dhunshëm dhe armën ka drejtuar në drejtimin e saj, ka thyer derën e banakut duke kërkuar para ndërsa tjetri ka dal në derë duke drejtuar armën përballë personave që gjendeshin në pastiçerinë “K.”. Në arkë ka pasur diku rreth 5.500 €, por në sirtar ka pasur shumën prej 2.480 €, të cilat i ka marrë personi më i gjatë. Pasi që kanë marrë parat përmes korridorit të ndërtesës në anën e prapme kanë ikur në drejtim të Lagjes Kurilla, në drejtim të anës së djathtë nga edhe kishin ardhur. Në ato momente nuk ka vërejtur a kanë pas dorëza mirëpo më vonë nga shikimi i incizimit filmik përmes kamerave ka vërejtur se kanë pasur dorëza sterile. Në shqyrtimin kryesor ka shtruar se personi më i gjatë është afruar tek kabina ku ka punuar, ka dashur të hynte brenda, së pari ka rezistuar me derë duke e shtyrë, ai po ashtu ka shtyrë derën dhe pas disa shtyrjeve dera është thyer, në pyetjen e tij ku janë parat ka treguar vendin, edhe pse personi nuk iu është kërcënuar, ka përjetuar stresse të madh.

Gjykata ka dëgjuar dëshmitarin A. K. i cili në mes tjerash ka theksuar se punon në kafeteri C., ditën kritike rreth orës 17:00 deri sa ka pastruar disa gota ka vërejtur dy persona në shpejtësi nga prapa të cilët janë futur në lokalet W. U., fillimisht ka hyrë personi më i gjatë, ndërsa tjetri ka qëndruar jashtë te dera. Menjëherë ka lajmëruar pronarin Xh. V. i cili ka qenë i ulur në lokal dhe i ka thënë se dy persona me maska kanë hyrë në W. U. Ai i cili ka qenë jashtë ka ngritur revolen në drejtim të pronarit ndërsa tjetri ka hyrë brenda në lokal, ka shtyrë derën dhe ka filluar të merrte të gjitha parat. Pasi që ka marrë parat menjëherë janë larguar që të dy nga pjesa e prapme e lokalit. Njëri i cili ka qenë më i gjatë dhe më i shëndoshë ka patur të veshur një duks të zi, trenerka me ngjyere të zezë dhe në kokë ka pasur maskë ngjyrë të zezë dhe dorëza, ai në dorë kishte një revole me ngjyrë të zezë. Tjetri ka qenë më i dobët, ka pasur të veshur trenerka ngjyrë të zezë dhe një duks në të njëjtën ngjyrë dhe në dorë ka pasur një revole. Edhe ai ka pasur të vendosur një maskë të zezë.

Dëshmitari Xh. V. në mes tjerash ka dëshmuar se i kujtohet se me datën 09.10.2010 në filialin W. U. ka pasur një plaçkitje nga persona të maskuar diku në ora 16:30 minuta, deri në ora 17:00, ka qenë duke i numëruar parat në lokalin e vet, në punë ka qenë edhe punëtori A. K. i cili në një moment i ka thënë “baci Xh., a është tu ndodh një ngjarje te W. U.”, menjëherë u ngrit dhe ka dalë jashtë te dera e lokalit dhe posa e ka hapur derën një person i maskuar dhe i armatosur e ka drejtuar revolen, ka hyrë dhe ka thënë “ri aty mos u afro”, pas fjalëve nuk ka guxuar të afrohet dhe vetëm ka shikuar nga brendia e lokalit, nuk ka mund të vërejë dialektin pasi që nuk ka dëgjuar mirë se çfarë zëri kishte, njëri ka qenë më i gjatë ndërsa tjetri më i shkurtë, të dy kanë pasur maska të zeza dhe revole në duar, veshja e tyre ka qenë në të zez, personi më i shkurt ka qenë te dera e lokalit W. U. ndërsa ai me trup më të gjatë ka hyrë te banaku duke e shtyrë derën dhe ka hyrë brenda tek punëtorja dhe ka marrë parat e arkës. E gjithë kjo ngjarje ka ndodhur dhe ka zgjatë në periudhën kohore prej 5 minute, pastaj kanë ikur prapa dhe nuk

e di se në çfarë drejtimi janë larguar, pasi që janë larguar ai ka shkuar në lokalin W. U. dhe ka parë punëtoreshen e cila ka qenë e frikuar dhe e stresuar shumë, janë afruar dhe njerëz të tjerë dhe dikush ka njoftuar policinë me telefon.

Dëshmitari E. K. në dëshminë e tij ka theksuar se kur ka ndodhur grabitja në W. U. ka qenë në kafeteri C. duke pirë kafe, ora ka qenë rreth 16:30 minuta, ka vërejtur kur kanë hyrë dy persona të maskuar, njëri ka pasur një shall të vendosur në qafë ngjyrë e zezë me të bardhë, ka qenë më i dobët, ka pasur të veshur trenerka, nuk i kujtohet ngjyra por ka pasur vija të bardha anash dhe një duks ngjyrë e zezë, ndërsa tjetri ka qenë më i shëndoshë ka pasur të vendosur maskën në kokë me ngjyrë të zezë, ka pas të veshura pantallona me ngjyrë të zezë, duks e dorëza të të njëjtës ngjyrë. Që të dytë kishin në duar nga një revole me ngjyrë të zezë. Fillimisht në W. U. ka hyrë personi më i shëndoshë në dukje dhe u drejtua në drejtim të punëtoreshes e cila ka filluar të bërtas, ndërsa ai në dukje më të dobët ka pasur në duar një revole ngjyrë të zezë dhe ka qëndruar te dera hyrëse. Ka qenë në lokal brenda kur i është drejtuar revolva dhe nga frika nuk ka guxuar të incizonte. Përndryshe shpesh ka vizituar këtë kafeteri “C.”, në atë moment aty kanë qenë pronari i kafeterisë, kamarieri A., një person që ka punuar në parking te Shtëpia e Bardhë. Nuk e njeh personat me emrat B. V. dhe R. K., pasi që grabitësit janë larguar nga W. U., ka shkuar deri te lokali, te punëtorja e cila ishte shumë e shqetësuar.

Në shqyrtimin kryesor eksperti B. D. ka deklaruar se punon afër 8 vite në operatorin “VALA”, në Departamentin e Planifikimit të Rrjetit, si inxhinier dhe aty përdorin harta për çështje të planifikimit të rrjetit dhe për një klient mund të dihet se gjatë komunikimit prej cilës celule ka qenë duke u shërbyer. Celula është një zonë gjeografike e mbuluar nga një antenë me dimensione të cilat janë variable, nëpër zona urbane janë celula më të vogla ndërsa nëpër zona rurale janë më të mëdha. Antena në lagjen Kurilla I, e mbulon pjesën lindore dhe veri-lindore të Prizrenit, të lagjes Kurillë ku përfshinë pjesën duke filluar prej rrugës së Marashit deri te qendra sportive Sezair Suroi dhe në këtë zonë është probabiliteti më i madhe që të mbuloj PZ Kurilla I, duke u bazuar në raportin e Postës, shihet se nr.045-3... me datën 09.12.2010, diku rreth orës 17:43:29 ka qenë duke u shërbyer nga celula PZ Kurilla I, në bazë të raportit të PTK, operatori VALA, në fund të raportit është shënuar se këtë nr. i telefonit e mbulon PZ Kurilla I, mirëpo ndërtesa te rrethi rruga Qazim Berisha mund të mbuloj edhe celulat tjera që mund të jenë PZ, Sh.e Bardh dhe PZ Kurilla II, por edhe PZ Qylhani II etj. Për të regjistruar celula në antenën, telefoni duhet të jetë i hapur dhe nëse është i fikur atëherë rruhet celula e fundit në të cilën ka qenë telefoni.

Gjatë shqyrtimit kryesor dëshmitari F. Sh. ka dëshmuar se e njeh e të akuzuarin B. V., në atë kohë ka punuar në shtëpinë e R. K., ku ka qëndruar i akuzuari dhe pas njoftimit janë takuar dy tri herë. Një ditë punëtorët e tij kanë marrë B. për të punuar së bashku duke bartur pllaka qeramike. Për atë ditë i ka paguar mëditjen dhe së bashku kanë pirë kafe në kafeteri C. te ndërtesa e Globalit, i kujtohet se ka qenë kohë dimri. Më asnjëherë nuk ka qenë i ftuar të punoj me ta.

Dëshmitari F. Th. në deklaratën e vetë ka theksuar se rasti konkret ka ndodhur me datën 09.12.2011, ndërsa rasti në L. V. me datën 30.12.2010, ka punuar në të dy rastet si polic hetues së bashku me dy koleg të tjerë. Gjatë punimit në rastin e L. V. dhe gjatë hetimeve lidhur me masat e fshehta kanë arritur që të identifikojnë një telefon të grabitur në L. V., dhe kanë kuptuar që këtë telefon ka pasur në shfrytëzim personi me emrin E. G. nga Prizren. Në deklaratën e vet E. G. ka theksuar se këtë telefon ia ka dhënë R. K. dhe



B. V. si dhuratë dhe në bazë të bastisjes në shtëpinë e R. K. janë gjetur dhe disa telefona për të cilët kanë dyshuar se janë marrë në kazino L. V. Tjetër ditë vëllai i të akuzuarit R. K., V. K. ka treguar për vendin se ku gjendet një laptop i cili është vjedhur në L. V. dhe një pistoletë dhe sipas V. edhe laptopi edhe pistoletë kanë qenë të B. Në bazë të këtyre provave kanë filluar hetimet edhe për rastin konkret dhe për shkak të afërsisë së të dy lokacioneve, periudhës kohore, se në dy raste kanë qenë të dyshuar dy persona, përmasat trupore përafërsisht të njëjtë, dhe gjatësia e tyre, mënyra e kryerjes dhe rolet e tyre që kanë pasur gjatë kryerjes së grabitjes, mënyra e veshjes e të dyshuarve, fakti se i dyshuar R. K. në W. U. ka tërhequr para në emër të B. V. edhe pse nuk ka dhënë sqarime pse kanë nxjerrë parat në emër të B., edhe një fakt tjetër në të cilin kanë bazuar dyshimin ka qenë fotografitë e nxjerra nga drejtorja e policisë së Kosovës – tekniku i kriminalistikës, sipas raportit R. Z., gjatë marrjes në pyetje B. V. nuk ka dhënë sqarime pse e ka mbajtur pistoletën edhe pse ka pranuar faktin se është e tij, hartografia e cila tregon se para rastit B. ka qenë në afërsi të lokacionit W. U. Pasi që policia pas rastit në L. V. ka shkuar për bastisje në shtëpinë e R. K., atje ka qenë B. V. duke qëndruar në atë shtëpi, në një dhomë të kësaj shtëpie në katin e sipërm kanë gjetur një çantë me rrobat e B. dhe nga familja kanë qenë të informuar se B. i ka ndihmuar në ndërtimin e shtëpisë dhe kohë pas kohe ka banuar në atë shtëpi. Është e vërtetë që rruga për të shkuar në “Bajër”, mundet me kaluar në atë pjesë, afër shtëpisë së bardhë dhe vendit ku është bërë grabitja në lokacion W. U. Në bazë të hartografisë B. V. ditën kritike, në ora 15:57 minuta, ka qenë te “Qylhani”, në ora 16:50 minuta, ka qenë në afërsi të shtëpisë së bardhë, ndërsa grabitja ka ndodhur në 16:50 minuta dhe se po ashtu nga hartografia shihet se në ora 17:43 minuta, ka qenë në Prizren afër PTK në lagjen Kurilla.

Gjykata ka analizuar mbrojtjen e të akuzuarit B. V. dhe e ka pranuar në atë pjesë se nuk është kontestuese se ka shkuar në agjencinë W. U. N. për të ngritur parat të cilat i ka dërguar familja nga Amerika, se ka poseduar një pistoletë të cilin policia gjatë kontrollit në shtëpinë e R. K. ia ka konfiskuar. Këto fakte janë vërtetuar në bazë të mbrojtjes së tij si dhe provave materiale siç janë raporti mbi ngritjen e parave nëpër agjencitë e ndryshme W. U. si dhe në agjencinë N.

Gjykata ndërkaq nuk i ka besuar mbrojtjes së të akuzuarit në atë pjesë se nuk e di ku ka qenë ditën kritike, se në emër të tij parat i ka ngritur R. K. dhe se nuk ka dëgjuar për rastin e grabitjes në agjencinë N. Kjo sepse në bazë të raportit të hartografisë vërtetohet se vetëm 6 minuta para se të ndodh rasti, i akuzuari ndodhej shumë afër agjencisë në fjalë, disa herë ka thirrur të akuzuarin R. K. pak para rastit dhe menjëherë pasi që ka ndodhur rasti, e kjo vërtetohet në bazë të listës së hyrje dalje të telefonike në mes tyre. Duke marrë parasysh se ndarja e provave mund të bëhet në pikëpamje të raportit të provave ndaj faktit vendimtar i cili dëshmohet dhe pos provave direkte ekzistojnë edhe ato indirekte, me të cilat drejtpërdrejtë vërtetohet ndonjë fakt tjetër e përmes këtij në mënyrë direkte shërben si provë i faktit vendimtar e ky është objekt i të provuarit. Duke pasur parasysh rastin konkret lidhur me këtë edhe faktet jokontestuese se i akuzuari B. pas ardhjes në Kosovë, konkretisht në Prizren, në një qytet ku nuk e njih askënd, duke bartur me vete një çantë me gjëra personale në mes tjera edhe një pistoletë. Në këtë situatë ai rastësisht shkon në teqe ku e njofton të akuzuarin R. K., me të cilin fillon një shoqëri të re gjatë së cilës edhe janë vizituar në mes vete, kur ka ndodhur edhe që të qëndroj me ditë tek shtëpia e të akuzuarit R. K. I akuzuari B. është i papunë dhe jeton nga ndihma e familjes nga larg, e cila nuk e arrin shumën më të lartë se 150 Euro.

Në bazë të provave të administruara gjykata pa dyshim ka marrë konkluzion se ekzistojnë mjaftë arsye të cilat shpijnë në bindje për ekzistimin e fakteve me të cilat provohet ngjarja në situatë objektive, këto duke pas parasysh edhe deklaratat e dëshmitarëve dhe të dëmtuarës të cilat kanë të bëjnë me përshkrimin e konstrukcionin trupor të grabitësve, i cili i përgjigjet konstrukcionit të të akuzuarve, e kjo është vërtetuar edhe në bazë të incizimeve dhe foto dokumentacionit të cilat janë bërë në bazë të incizimeve. Nga ana tjetër edhe në bazë të incizimeve të bëra edhe në L. V. edhe në W. U. N., pas krahasimeve është vërejtur se në veshjen e sipërme – trenerkën e njërit grabitës është vërejtur dy vija të bardha, nga nxirët konkluzioni se në të dy lokalet ka qenë personi i njëjtë. Në këtë drejtim ka dëshmuar eksperti R. Z. i cili në mes tjerash ka theksuar se me datën 25.05.2011, nga njësia hetimore Rajonale në Prizren, kanë pranuar dy raste, një në kazino L. V. dhe tjetra në W. U. dhe është kërkuar që të nxirën fotografitë imazhet e personave të dyshuar të cilët kanë kryer veprat penale në dy lokacione e përmendura. Po ashtu është kërkuar që të nxirren shenja identifikuese nga rrobat e personave të dyshuar apo nga sendet që kanë grabitur në vendin e ngjarjes. Duke vepruar sipas kërkesës në të dy rastet kanë tërhequr fotografitë e personave dhe kanë markuar shenjat identifikuese të rrobave që kanë pasur të veshur për të lehtësuar punën e hetuesve. Kanë vërejtur një ngjashmëri ndërmjet rastit të kazinos dhe rastit “W. U.”, ku një veshje e sipërme e personit të dyshuar në kazino e ka pas të veshur, ndërsa në rastin W. U. dyshohet që të njëjtat rroba i ka pas të lidhur për brezi, bazuar në dy vija të bardha veshja e sipërme është e kaltër, në të dy raste është përdorur e njëjta metodë. Nga hetuesi është informuar se tek të të dyshuarit e grabitjes në kazino është gjetur llaptopi në të cilin shihet një imazh i cili parqet flamurin e Zvicrës e cila është grabitur në kazino. Pas shikimit CD-së me incizimin e bërë në W. U. dhe në L. V., sa i përket vijat të cilat i kanë vërejtur në veshjet mund të jenë të ngjashme duke u bazuar në ngjyrë dhe në dy vijat e bardha.

Nga të cekurat më lart gjykata ka vërtetuar se në veprimet e të akuzuarit formohen elementet e veprës penale si në shqiptim të aktgjykimit, për të cilën vepër e ka shpallur fajtor dhe gjykuar sipas ligjit.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 73 dhe 74 të KP, të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit dhe me vlerësimin e të gjitha rrethanave rënduese dhe lehtësuese gjykata ka pasur parasysh që secila prej këtyre rrethanave veç e veç janë vlerësuar në ndërlidhje me të gjitha rrethanat e tjera të cilat ndikojnë në matjen e dënimit, në rastin konkret duke gjetur si rrethana rënduese shkallën e rrezikimit të vlerës së mbrojtur- shikuar përmes peshës së veprës së kryer duke pasur parasysh pasojën abstrakte me krijimin e kushteve që vlera e mbrojtur mund të vijë në rrezik, në rastin konkret duke pasur parasysh edhe pasojën konkrete se me përdorimin e dhunës dhe kërcënimit ndaj punëtorit është shkaktuar shkalla e lartë e frikës dhe traumës, se është recidivist i veprave penale të natyrës së njëjtë si dhe shkallën e rrezikut shoqëror të tij dhe të veprës së kryer; pos kësaj gjykata ka marrë parasysh edhe rrethanat lehtësuese si sjellja korrekte gjatë tërë procedurës, i papunësuar, i gjendjes së varfër ekonomike, prandaj gjykata me aplikimin e dispozitës së nenit 76 par. 1 pika 1.3 të KP, ia shqiptoi dënimin me burg, duke konsideruar se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është marrë në bazë të nenit 450 të KP.

Vendimi mbi kërkesën pasurore juridike është marrë në bazë të nenit 463par.2  
KPP.

Nga të cekura më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**  
**Departamenti për Krime të Rënda**  
**P.nr. 20/12, dt. 04.05.2016**

**Sekretaren juridike,**  
**Valdete Zurnaxhiu**

**Kryetari i trupit gjykues**  
**Raima Elezi**

**UDHËZIMI JURIDIK:** pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh pas marrjes së aktgjykimit nëpërmjet të kësaj gjykate – Gjykatës së Apelit në Prishtinë.

**Përkthyesja,**  
**Asnije Berisha**